



Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës Komora Fizioterapeuta Kosova Kosovo Chamber of Physiotherapists	
NR. I PROTOKOLIT	<u>316</u>
NR. I FAQEVE TË BASHKANGJITURA	<u>03</u>
DATA	<u>06.03.2016</u>
PRISHTINË - KOSOVË	

Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova
Kosovo Chamber of Physiotherapists

Ftesë për Ofertim: Auditimi i Pasqyrave Financiare (burimi dhe përdorimi i mjeteve).

OFTK fton Kompanitë audituese dhe auditorët që të ofertojnë për të kryer shërbimet e Auditimit sipas IFRS dhe Standardeve ndërkombëtare të auditimit.

Data e njoftimit:	06.03.2016.
Data e dorëzimit të ofertave:	05.04.2016
Data e përzgjedhjes:	08.04.2016
Data e përfundimit:	28.04.2016

Objekti i kontratës: Marrëveshje e shërbimit.

Autoriteti kontraktues: Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës (OFTK)

➤ HYRJE

Përshkrimi i programit

Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës (OFTK) është themeluar si organizatë profesionale me Ligj për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë në vitin 2013. OFTK përfaqëson interesin e anëtarëve të saj, fizioterapeutëve të Kosovës.

OFTK mbështetur në legjislacionin në fuqi ka tre burime kryesore të të hyrave përmes së cilës realizon të hyra vetanake nga:

- të hyrat nga anëtarësia
- taksa për licencim dhe ri-licencim si dhe lartësia e taksës për lëshimin e certifikatave, vërtetimeve dhe dokumenteve tjera për të cilat Oda mban evidencë zyrtare;
- donacionet e tjera si dhe të hyrat tjera në pajtim me ligjin.

Siç është e paraparë me statut, OFTK është e obliguar të raportoj në bazë të rregullt organeve të saja të larta siç është Këshilli dhe Kuvendi.





Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova

Kosovo Chamber of Physiotherapists

Evidenca kontabël për vitet afariste janë mbajtur ne programin e kontabilitetit ABACUS SOFT.

QËLLIMI I KONTRATËS DHE REZULTATET E PRITURA

2.1 OBJEKTIVA E PËRGJITHSHME

Objektiva e përgjithshme është të prodhoj një raport të auditimit të pasqyrave financiare të Odës të Fizioterapeutëve të Kosovës.

2.2 OBJEKTIVA SPECIFIKE

Auditimi duhet të kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA)

2.3 REZULTATET E PRITURA

Një raport i plotë pritët në fund të angazhimit i cili do të përmbajë:

Raportin e auditimit me opinion të auditorit të pavarur ,
Letrën e menaxhmentit që përbëhet nga rekomandimet për ndryshimet nëse është e nevojshme në praktikat dhe procedurat për të përmbushur mangësitë.

LOGJISTIKA DHE KOHA

Angazhimi për auditim siç kërkohet do të ndërmerret në selinë e OFTK në Prishtinë / Kosovë.
Angazhimi për auditim planifikohet të filloj me 08.04.2026 dhe do të përfundoj më 18.04.2026.

KËRKESAT

Ftohen aplikues nga firmat e auditimit ose auditorët ligjor të cilët përmbushin kriteret në vijim.

- Të jetë auditor ligjor dhe të mbajë certifikatë të vlefshme të praktikës të lëshuar nga KKRF.
- Kanë përvojë domethënëse në auditim sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (SNK)
- Të ketë së paku tri (3) vite përvojë në auditimin e pasqyrave financiare të OJQ-ve

RAPORTIMI

Auditori do të diskutoj me Kryetarin dhe me Këshillin Drejtues të OFTK për gjetjet paraprake dhe propozimet, në një takim para dorëzimit të raportit final. Në këtë takim auditori do të:





Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova

Kosovo Chamber of Physiotherapists

- Të prezantoj draft raportin e auditimit
- Të prezantoj draft letrën e menaxhmentit
- Nënvizoj problemet e ballafaquara
- Rekomandoj zgjidhjet e mundshme në letrën e menaxhmentit.

Kryetari i OFTK dhe Këshilli i OFTK do të komentojnë në mënyrë të shkruar draft raportin final brenda 2 ditësh pas pranimi të raportit. Auditori do të përfshijë komentet në raportin final brenda 2 ditësh pasi janë pranuar nga Kryetari dhe Këshilli Drejtues.

Raporti final (duke përfshirë opinion e nënshkruar) në 3 kopje dhe një version elektronik përfshirë të gjitha konkludimet dhe rekomandimet do t'i dorëzohet OFTK me se largu deri me datën 28.04.2026.

Raportet do të dorëzohen në gjuhën shqipe.

Kontrata ka afat kohorë 1 vjeçarë me mundësi vazhdimi me marrëveshje të shkruar. Shërbimi i auditimit konsiderohet i përfunduar pas dorëzimit të të gjitha materialeve sipas afateve të përcaktuara në ftesën për ofertim.

Ofertuesit e interesuar së bashku me ofertën duhet të dorëzojnë edhe dokumentacionin shtesë si në vijim:

- Certifikata e regjistrimit të biznesit;
- Certifikata e regjistrimit fiskal;
- Licenca/ certifikatë nga organet kompetente për kryerjen e punëve;
- Referenca mbi kryerjen e punëve të ngjashme;
- CV-të e auditorëve që do të bëjnë auditimin.

Oferta duhet të përmbajë:

- Planin gjeneral të auditimit;
- Afatin kohor të propozuar;
- Kërkesa për dokumentacionet që duhen të përgatiten paraprakisht nga ana e OJQ-së;
- Tarifat për auditorë;
- Shumën totale të auditimit.

Ofertat duhen të dërgohen ne email adresën: info@oftk-ks.org ose ne zarf ne selinë e OFTK-së: Kompleksi i QKUK, Klinika e Mjeksisë Fizikale me Rehabilitim, Kati I, Prishtinë, Kosovë.

Ftesë për ofertim:

Auditimi i Pasqyrave Financiare (burimi dhe përdorimi i mjeteve).

Me respekt,
OFTK;

Adresa: Kompleksi i QKUK, Klinika e Mjeksisë Fizikale me Rehabilitim, Kati I I-rë, RKS-10000.
Address: UCCN Complex, Physical Medicine Clinic with Rehabilitation, 1st Floor, RKS-10000.
Tel +383(0) 45 460 551; e-mail info@oftk-ks.org; ëeb : ëëë.oftk-ks.org

Oda e
Fizioterapeutëve
të Kosovës

